

Fshati Grudë e Re, Shkodër, sipas të cilit rezulton se, Familja e D.Gj. ka përfituar në pronësi 8400m2 tokë bujqësore.

Në përgjigje të informacionit dhe shpjegimeve të kërkuara Regjistruetit të ZVRPP, Shkodër, rreth kësaj çështjeje, ai, me shkresën nr. 9233 Prot, datë 05.12.2017, drejtuar Avokatit të Popullit, bënë të ditur, midis të tjerave, se;

“ ... Pranë ZVRPP, Shkodër, është paraqitur kërkesa me nr.8742, D28.07.2015, me anë të së cilës z.D.Gj. ka depozituar dy akte të marrjes së tokës në pronësi, në bazë të së cilës ka marrë përgjigje më Datë 23.09.2015, dhe i gjithë dokumentacioni i paraqitur në aplikim nga ana e tij i është rikthyer... ”.

Shkresa datë 23.09.2015, sipas të cilës Regjistrueti i ZVRPP, Shkodër, pretendon se ka kthyer përgjigje z.D.Gj., nuk është vënë në dispozicion të Avokatit të Popullit.

Referuar procedurës që duhet ndjekur për regjistrimine titullit të pronësisë, konstatojmë se; nenet 193 dhe 196, të Kodit Civil, parashikojnë respektivisht, se;

“Neni 193

Duhet të regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtshme:

“ ...

h) vendimet e gjykatave ose organeve kompetente shtetërore që përkatësisht përmbajnë fitimin ose njohjen e pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, pjestimin e pasurive të paluajtshme ose që deklarojnë të pavlefshme veprimet juridike për kalimin e pronësisë të regjistruar më parë rregullisht, si dhe aktet e përmbartimit gjyqësor për sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme ose shitjen në ankant të tyre.

Neni 196

Gjykatat, noterët, përmbartuesit gjyqësorë dhe organet e tjera shtetërore detyrohen t'i dërgojnë për regjistrim zyrës që administron regjistrin ku ndodhen pasuritë e paluajtshme, kopje të vendimit ose të aktit që përmban fitimin, njohjen, ndryshimin, pushimin e një të drejte pronësie të paluajtshme, ose një të drejte reale mbi atë, ose që deklarojnë të pavlefshme veprime juridike për kalimin e pronësisë të regjistruar më parë”,

Bazuar në parashikimet e sipërcituara, si dhe akteve të vëna në dispozicion prej ZVRPP, Shkodër, sipas shkresës nr. 9233 Prot, datë 05.12.2017, konstatojmë se, Komuna Rrethina, Shkodër, me shkresën nr. 371 prot, datë 13.05.2013, ka dërguar për regjistrim, pranë ZVRPP, Shkodër, kopje të AMTP-së nr.175, datë s'ka, si dhe Formularin nr.6, në të cilët përcaktojnë qartë sipërfaqja prej 8400m2, Parcela nr.102, e përfituar në pronësi prej Familjes Gjeka, sipas ligjit 7501/1991, “Për tokën”. Referuar normës për frymë, si dhe përbërjes familjare të Familjes Gjeka, (Çertifikatë për gjendjen familjare datë 27.08.1992) rezulton se, trajtimi i saj me tokë të pronësi është kryer në mënyrë korrekte. Sipërfaqen e tokës prej 8400m2 ankuesja, shprehet se, e posedojnë qetësisht familjarisht dhe se nuk kanë asnjë konflikt me kufitarët. Gjithashtu, referuar Plan rievimit të vënë në dispozicion prej ZVRPP, Shkodër, dhe përgatitur prej Shoqërisë “E” Sh.p.k., rezulton se, pasuria e

Familjes Gj, është e regjistruar me nr.102/7, vol 1, Faqe 204, në regjistrin e ZVRPP, Shkodër, me sipërfaqe = 7980m².

Regjistruesi i ZVRPP, Shkodër, në shkresën nr. 9233 Prot, datë 05.12.2017, drejtuar Avokatit të Popullit, konfirmon se, ka të administruar AMTP nr.174, datës s'ka, për trajtimin me tokë bujqësore të Familjes Gj, por nuk jep informacion se cili subjekt i'a ka venë në dispozicion, ndodhur në kushtet kur AMTP-ja nr.175, datë s'ka, i është venë në dispozicion prej Komuna Rrethin, konform parashikimit të nenit 196 të Kodit Civil.

Në situatën në të cilën ndodhet çështja, lind pyetja;

- Cila është pengesa e rregjistrimit të diferencës së tokës prej 6000m², konform AMTP-së nr.175, datë s'ka (8400m² – 2400m² = 6000m²) Familjes Gj?

ZVRPP, Shkodër, ka pasur dhe ka detyrimin e përmbushjes së detyrimeve ligjore në marrëdhënie me subjektin D.Gj, për regjistrim e titullit të pronësisë AMTP-së nr.175, datë s'ka, të nxjerr prej Komisionit të Ndarjes së Tokës, Fshati Grudë e Re, Shkodër, referuar dhe akteve të dërguara prej Komuna Rrethinë me shkresën nr. 371 prot, datë 13.05.2013, si;

- Formulari nr.6
- Çertifikatë për gjendjen familjare të Familjes Gj, datë 27.08.1992.
- Plan rievimit të përgatitur prej Shoqërisë "E" Sh.p.k., etj.

Konstatohet se Regjistruesi i ZVRPP, Shkodër, edhe pse administron AMTP-në nr.175, datë s'ka, të Komisionit të Ndarjes së Tokës, Fshati Grudë e Re, Shkodër, nuk procedon për nxjerrjen e aktit, sikurse parashikuar në nenin 5/d të Ligjit nr.7843, datë 13.07.1994 "*Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme*", i ndryshuar, apo nenin 40, të Ligjit nr.332012 "*Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme*", i ndryshuar. Ky qëndrim i mbajtur është i pajustificueshëm, pasi nuk vjen në përputhje me parimin e ligjshmërisë, parimin e dhënies së ndihmës aktive, parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit, parimit të proporcionalitetit, parimit të drejtësisë dhe i paanësisëm, parimi të përgjegjësisë parimit të marrjes së vendimeve, parimit të deburokratizimit dhe efikasitetit, sikurse parashikuar në nenin 4, 10, 11, 12, 13, 15, 16, dhe 18, të K.Pr.A.

Gjithashtu, qëndrimi që mbahet prej ZVRPP, Shkodër, në trajtimin e kësaj çështjeje e vlerësojmë në cënim të së drejtës të pronësisë, sikurse sanksionuar në Nenin 41 të Kushtetutës, apo parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor sikurse sanksionuar në Nenin 42 të Kushtetutës si dhe nenit 6/1 të Konvetës Europiane e të Drejtave të Njeriut (miratuar me Ligjin nr.8137, datë 31.07.1996), nenin 1 të Protokollit nr.1 të Konvetës, si rrjedhojë e mosmarrjes së masave në afatin e vendosur për regjistrimin dhe lëshimin e dokumenteve të pronësisë në favor të subjektit ankues.

Qëndrimi i ZVRPP, Shkodër, në procesin e rregjistrimit të AMTP-në nr.175, datë s'ka, të Komisionit të Ndarjes së Tokës, Fshati Grudë e Re, Shkodër, si dhe lëshimit të dokumenteve të pronësisë për pasurinë e paluajtshme në fjalë, ka cënuar dhe cënon marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për regjistrimin e titujve të pronësisë, të cilat sigurojnë jo vetëm veprimtarinë e rregullt të organit që ju përfaqësoni, por dhe mbrojtjen

e interesave të ligjshme të shtetasve apo të shtetit, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal kundër veprimeve ose mosveprimeve kriminale. Në situatën juridike në të cilën ndodhet çështja, Avokati i Popullit, nisur nga parimi i zbatimit të ligjshmërisë, rritjes së efektivitetit në veprimtarinë e ZVRPP, Shkodër, bazuar në sanksionimin e nenit 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga Administrata publike”, si dhe nenin 21/b të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, i cili parashikon se : “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”,

REKOMANDON

Ushtrimi kontrollit mbi veprimtarinë e ZVRPP, Shkodër, për zbatimin e legjislacioni, si dhe i gjithë detyrave për sigurimin e mirëfunksionimit, në çështjen e shtetases S. G..

Lidhur me shqyrtimin që do të kryhet rekomandimit të dhënë, konform nenit 19 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, kthimi i përgjigjes duhet të bëhet brenda 30 ditëve nga data e dërgimit të kësaj shkrese.

Duke besuar në bashkëpunimin tuaj.

Bashkëlidhur ju dërgojmë kopjet e akteve të vena në dispozicion prej ZVRPP, Shkodër, si; Kopje të Shkresës Nr. 9233 Prot, Datë 05.12.2017, të ZVRPP, Shkodër, drejtuar Avokatit të Popullit,

Kopje të AMTP-së nr.174, datë s’ka, të Komisionit të Ndarjes së Tokës, Fshati Grudë e Re, Shkodër.

Kopje të Kartela e pasurisë së paluajtshme për pasurinë 102/7, ZK 1869.

Kopje të kërkesës (aplikim nr.3742, datë 29.07.2016, kryer prej D.Gj. pranë ZVRPP, Shkodër.

Kopje të shkresës nr. 1542 Prot, datë 19.03.2014, të ZVRPP, Shkodër, drejtuar D.Gj..

Kopje të shkresës nr. 587 Prot, datë 30.01.2014, të ZVRPP, Shkodër, drejtuar D.Gj..

Kopje të Kartela e pasurisë së paluajtshme për pasurinë 102/6, ZK 1869.

Kopje të shkresës nr.2958 prot, datë 15.05.2013 të Këshillit të Qarkut, Shkodër, drejtuar ZVRPP, Shkodër.

Kopje të shkresës nr. 371 Prot, datë 13.05.2013, të Komuna Rrethin, Shkodër, drejtuar ZVRPP, Shkodër.

Kopje të AMTP-së nr.175, datë s’ka, të Komisionit të Ndarjes së Tokës, Fshati Grudë e Re, Shkodër.

Plan Rilevim i pasurisë nr.102/7, vol 1, Faqe 204, ZK 1869, kryer prej Shoqërisë “E” Sh.p.k.

Çertifikatë familjare lëshuar më datë 07.05.2013, prej Zyra e Gjendjes Civile Rrethina, Shkodër, mbi përbërjen familjare të Familjes Gj më datë 27.08.1992.

Kopje të “Lista (nr.32) e familjeve që morën tokë në pronësi, në përdorim... (për numrat nga 171 e deri 176”.

Kopje të Çertifikatës “Për vërtetim pronësie” datë 16.02.2004, lëshuar prej ZVRPP, Shkodër, për pasurinë nr. 102/7, ZK 1869, në favor të Familjes Gj së bashku me HRT.

Kopje të HTR përgatitur prej ekspertës Vitore Isfufi dhe nënshkruar dhe vulosur prej Regjistruesit të ZVRPP, Shkodër.0

KOMISIONERI

Arben SHKEMBI